

**L I G J**  
**Nr. 8918, datë 4.7.2002**

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8087, DATË 13.3.1996 “PËR SIGURIMIN SHOQËROR  
SUPLEMENTAR TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË USHTARAKËVE TË MINISTRISË SË RENDIT  
PUBLIK DHE TË SHËRBIMIT INFORMATIV SHTETËROR”, NDRYSHUAR ME LIGJIN  
NR.8521, DATË 30.7.1999**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
V E N D O S I:**

Në ligjin nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, ndryshuar me ligjin nr.8521, datë 30.7.1999 bëhet kjo shtesë:

**Neni 1**

Në nenin 7, “Kushtet për përfitim”, në fund të paragrafit të dytë, pas fjalëve “Në kohën e shërbimit aktiv përfshihet:”, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Koha si punonjës i reparteve të Radiozbulimit të Forcave të Armatosura që, sipas funksionit organik, kanë kryer detyrën e punonjësit të drejtimit dhe të operatorit të radiozbulimit (punonjës posti) si punonjës civil para titullimit ose rritullimit si ushtarak aktiv.”

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2003.

**Shpallur me dekretin nr. 3408, datë 12.7.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**